

VENDIM
Nr. 518, datë 16.8.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1619, DATË 2.7.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË
QEVERISJES VENDORE PËR EFEKT PAGE DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, dhe të neneve 24, 32 e 54 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1619, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronjat “a” deri në “e” të pikës 1 të vendimit, ndryshohen si më poshtë vijon:

“a) Për Bashkinë e Tiranës:

- Kryetari 140 000 - 174 760 lekë;
- Nënkyetari 130 000 - 140 000 lekë.

b) Për njësitë e qeverisjes vendore me mbi 100 000 banorë:

- Kryetari 92 000 - 140 000 lekë;
- Nënkyetari 60 000 - 93 000 lekë.

c) Për njësitë e qeverisjes vendore me 50 001-100 000 banorë:

- Kryetari 60 000 - 116 000 lekë;
- Nënkyetari 49 000 - 91 000 lekë.

ç) Për njësitë e qeverisjes vendore me 20 001-50 000 banorë:

- Kryetari 51 000 - 91 000 lekë;
- Nënkyetari 41 000 - 78 000 lekë.

d) Për njësitë e qeverisjes vendore me 5 001-20 000 banorë:

- Kryetari 41 000 - 78 000 lekë;
- Nënkyetari 28 000 - 69 000 lekë.

dh) Për njësitë e qeverisjes vendore me nën 5 000 banorë:

- Kryetari 37 000 - 55 000 lekë;
- Nënkyetari 27 000 - 43 000 lekë.

e) Për Këshillin e Qarkut:

- Kryetari 87 000 - 132 000 lekë;
- Nënkyetari 57 000 - 91 000 lekë.”.

b) Lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të Bashkisë së Tiranës”, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr. 2 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe për nëpunësit e komunave”, që përmendet në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Lidhja nr. 3 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të Këshillit të Qarkut”, që përmendet në pikën 4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

d) Lidhja nr. 6 “Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar”, që përmendet në pikën 5, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

dh) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. “Specialistët”, “përgjegjësit e sektorit” apo “drejtorët e drejtorive” të njësive të qeverisjes vendore, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së institucioneve të tyre dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme diplomë universitare “Master i shkencave” apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë “për kushte pune”, prej 10 000 lekësh, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Miratimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete do të bëhet, rast pas rasti, nga drejtoritë/njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, në njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përshkrimin e pozicionit të punës.”.

e) Lidhja nr. 5 “Struktura dhe kufijtë e pagave për punonjësit e policisë të bashkive e të komunave”, që përmendet në pikën 13, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ë) Në pikën 18, vlera “... 32 000 lekë në muaj ...” bëhet “... 33 000 lekë në muaj ...”.

f) Në pikën 19, vlera “... nga 20 000 deri në 32 000 lekë në muaj ...” bëhet “... nga 21 000 deri në 33 000 lekë në muaj ...”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2012, të përballohen nga të ardhurat e vetë njësive të qeverisjes vendore, për vitin 2012.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha